



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.Shk II.nr.94/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Radio Televizioni i Kosovës” me seli në rrugën Xhemajë Prishtina nr. 12 në Prishtinë kundër debitorit “Grand Media Enterteinment” ShPK me seli në lagjen Lakrishte, hyrja nr. 2, nr. 12 në Prishtinë, i cili përfaqësohet nga avokati M.M. me seli në rrugën Simon Shiroka nr. 29 në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2330/22 të datës 10.10.2023, me datë **24.04.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Radio Televizioni i Kosovës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2330/22 të datës 10.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2330/22 të datës 10.10.2023 në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Grand Media Enterteinment” ShPK me seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar në tërësi urdhrin përmbartimor P.nr.271/2019 i datës 24.07.2019 i përmbartuesit privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, dhe është përfunduar në tërësi procedurën përmbartimore në këtë çështje

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2330/22 të datës 10.10.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Radio Televizioni i Kosovës, ka paraqitur propozimin për përmbartim me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “Grand Media Enterteinment” ShPK me seli në Prishtinë që t’ia paguaj shumën prej 36,400.00€ me kamatëvonesë vjetore prej 8 % dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturat me numra si në vijim: nr. 1003517; nr. 1003593; nr. 1003611; nr.1003612; nr. 1003717; nr. 1003751; nr. 1003807; nr.1004166; me nr.1004184; nr.1004285; nr.1004328; nr.1004366; nr. 1004408 dhe nr. 1004445 të tij për Debitorin, të cilat faqja 2 nga 5 ia kishte bashkëngjitur Propozimit. Kreditori, gjithashtu Propozimit ia kishte bashkëngjitur edhe një fletë-kthesë (zbërthimi i kërimit) nga Posta dhe dokumentin e titulluar si “reklamim” të datës 08.07.2019 të lëshuar nga Posta. Përmbartuesi më 24.07.2019 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.271/2019 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri). Debitori më 01.08.2019 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai në ka pretenduar se Kreditori tashmë në një procedurë tjetër përmbartimore sipas urdhrin përmbartimor me numër P.nr.15/2018 të datës 18.01.2018 e ka realizuar kërkesën e tij nga faturat lëndore me nr. 1003717; nr. 1003751; nr. 1003807; nr.1004166; me nr.1004184 dhe nr.1004285, prandaj kërkesa e tij është shuar. Gjithashtu, ka deklaruar se faturat lëndore nuk janë të pranuar nga Debitori, meqenëse ato nuk janë as të nënshkuara e as të vulosura

nga ai, rrjedhimisht nuk i plotësojnë kushtet me LPP. Për fund ka deklaruar se Kreditori i ka bashkëngjitur disa fatura të vitit 2016, edhe pse kontrata është lidhur më 24.03.2017. Prapësimi ia ka bashkëngjitur propozimin për përbarim në procedurën tjetër të palëve të datës 19.01.2018 dhe urdhrin e asaj procedure me numër P.nr.15/2018 të datës 19.01.2018; faturat të cilat sipas tij janë përsëritur së bashku me listën përkatëse të reklamave, kontratën mbi të drejtën e emetimit televiziv të emisionit Super Sfida të lidhur më 24.03.2017 ndërmjet palëve të kësaj procedure dhe fletëtransferin e transaksionit bankarë në shumë prej 26,315.70€ të datës 08.03.2019 të Debitorit në xhirollogarinë e Përmbauesit për procedurën tjetër përbarimore, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj Prapësimin. Ai ka deklaruar se faturat të cilat janë përsëritur në këtë procedurë përbarimore e kanë vlerën totale 25,800.00€, ndërsa në procedurën tjetër për shkak të llogaritjes së gabueshme ishin kërkuar vetëm 25,000.00€, prandaj tani e kërkojnë vetëm shumën prej 800€ sipas këtyre faturave. Më tutje ka deklaruar se faturat lëndore i janë dorëzuar Debitorit përmes postës më 24.05.2019. Për fund ka deklaruar se faturat e vitit 2016 janë lëshuar në bazë kontratës 3394/14 së datës 24.12.2015, e vazhduar përmes ankesit 1 me nr. 3317/15 të datës 31.12.201, e cila ishte e vlefshme deri më 30.12.2016. Përgjigjes në prapësim ia ka bashkëngjitur shkresat që i kishe dorëzuar me Propozim, si dhe kontratën 3394/14 të lidhur mes tyre më 24.12.2015, ankesin 1 me nr. 3317/15 të lidhur mes tyre më 31.12.201, ndërsa nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale përbarimore për procedurën në gjykatës lidhur me përgjigjen në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2330/22 të datës 10.10.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Grand Media Enterteinment” ShPK me seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar në tërësi urdhrin përbarimor P.nr.271/2019 i datës 24.07.2019 i përmbauesit privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, dhe është përfunduar në tërësi procedura përbarimore në këtë çështje.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar faturat lëndore nuk e përmban as nënshkrimin e as vulën e Debitorit, që nënkupton se ajo nuk është pranuar nga Debitori. Si rezultat i mungesë së pranimit kësaj fature, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbarueshmërisë së dokumenteve të besueshëm. Për pasoj duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat lëndore si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, e njëjta nuk është e vërtetë e as nënshkruar nga debitori në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm. Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit se faturat lëndore janë dorëzuar nëpërmjet postës rekomandë të datës 24.05.2019, mirëpo gjykata vërtetoi se nga e njëjta nuk gjeti përshkrimin e faturave lëndore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II nr.94/24, me datë 24.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti